

**URDHËRESË ADMINISTRATIVE NR. 2002/3**

**ZBATIM I RREGULLORES SË UNMIK-ut NR. 1999/16 MBI  
THEMELIMIN E AUTORITETIT QENDROR FISKAL  
DHE ÇËSHTJE TË TJERA LIDHURA ME TË**

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm,

Në pajtim me autorizimin që i është dhënë me nenin 8 të Rregullores së ndryshuar të Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) nr. 1999/16 të datës 6 nëntor të vitit 1999 mbi Themelimin e Autoritetit Qendror Fiskal dhe çështje të tjera lidhur me të,

Duke marrë parasysh Rregulloren e UNMIK-ut nr. 1999/4 të datës 2 shtator të vitit 1999 mbi Valutën e lejuar për përdorim në Kosovë, Rregulloren e ndryshuar të UNMIK-ut nr. 1999/3 të datës 31 gusht të vitit 1999 mbi Themelimin e Doganës dhe Shërbimeve të tjera lidhura me të në Kosovë, Rregulloren e ndryshuar të UNMIK-ut nr. 1999/20 të datës 15 nëntor të vitit 1999 mbi Autoritetin Bankar dhe të Pagesave të Kosovës, Urdhëresën e ndryshuar administrative nr. 1999/2 të datës 2 shtator 1999 për Zbatimin Rregullores së UNMIK-ut nr. 1999/4 dhe Urdhëresën e ndryshuar administrative nr. 2001/8 të datës 6 qershor 2001 për Zbatimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 1999/16,

Duke pasur parasysh procesin e tashëm të konvertimit në valutën e Euros dhe nevojën për të penguar veprimet që mund të minojnë stabilitetin e sistemit financiar në Kosovë,

Me qëllim të avancimit të kontrollit për lëvizjen e parave të gatshme, letrave me vlerë dhe instrumenteve të transferueshme në Kosovë,

Me anë të kësaj shpall këtë Urdhëresë administrative:

Neni 1

Deklarimi i parave dhe i instrumenteve monetare

1.1 Nga çdo person i cili bart, transporton ose përcjell nga cilido shtet ose nga cilado pjesë e Republikës Federale të Jugosllavisë (RFJ) për në Kosovë para të gatshme, qeqe të udhëtarëve, qeqe bankare ose qeqe të arkatarëve të çfarëdo përshkrimi (më tej “instrumente apo mjete monetare”) që kapin shumën e përgjithshme prej më shumë se dhjetë mijë (10.000) eurosh do të kërkohet që:

(a) Të plotësojë, nënshkruajë dhe paraqesë para zyrtarëve të autorizuar në një pikë të autorizuar të hyrjes në Kosovë një formular të deklaratës me anë të të cilit deklarohet shuma e instrumenteve monetare (mjeteve) që barten, transportohen ose përcillen nga personi përkatës. Personi përkatës duhet të deklarojë poashtu me shkrim në formularin e deklaratës burimin e instrumenteve të tilla monetare dhe

(b) T'i ofrojë instrumentet e tilla financiare për inspektim nëse kjo kërkohet nga zyrtari i autorizuar.

1.2 Zyrtari i autorizuar, sipas veprimit të tij të lirë, mund të kërkojë nga personi ose të gjithë personat që udhëtojnë me personin për të cilin vlen neni 1.1 që t'iu përmbahen gjithashtu kërkesave të parashtruara në këtë nen.

## Neni 2

### Mosdeklarmi i instrumenteve monetare

2.1 Çdo person i cili nuk i përmbahet kushteve të nenit 1 konsiderohet se kryen një kundërvajtje të dënueshme me gjobë deri në 25% të vlerës së përgjithshme të mjeteve monetare që barten, transportohen ose përcillen. Megjithëkëtë, kur sipas gjykimit të zyrtarëve të autorizuar një mospërmbajtje e tillë është rezultat i ndonjë gabimi të parëndësishëm ose gabimi nuk është bërë me qëllim të paraqitjes së gabuar, fshehjes ose mashtrimit, zyrtarët e autorizuar mund të kërkojnë nga personi përkatës që ta plotësojë, nënshkruajë dhe paraqesë një deklaratë të përmirësuar. Nëse deklarata e tillë e përmirësuar është e pranueshme për zyrtarët e autorizuar, atëherë nuk do të ndërmerren kurrfarë masash kundër personit përkatës.

2.2 Zyrtari i autorizuar do t'i lëshojë personit që ka bërë kundërvajtje sipas nenit 2.1 një njoftim me shkrim në një formular standard ku theksohet natyra e kundërvajtjes dhe gjoba e shqiptuar e cila do të paguhet menjëherë.

2.3 Nëse personi i tillë nuk e paguan menjëherë gjobën e tillë, zyrtari i autorizuar do t'ia konfiskojë: (a) pjesën e vlerës së përgjithshme të të gjitha mjeteve monetare që barten, transportohen ose përcjellen nga personi përkatës që i tejkalon dhjetë mijë (10.000) euro dhe (b) atë pjesë që është barazvlefshme me 25% të vlerës së përgjithshme të të gjitha instrumenteve monetare që barten, transportohen ose përcjellen nga personi përkatës, cilado që është më e madhe.

2.4 Nëse vlera e instrumenteve monetare është e pandashme për qëllime të zbatimit të dispozitave të nenit 2.3, zyrtarët e autorizuar mund t'ia ndalin mjetet monetare në një vlerë të mjaftueshme për ta mbuluar shumën e kërkuar specifike.

2.5 Pas konfiskimit të bërë sipas nenit 2.3, zyrtarët e autorizuar do t'i lëshojnë personit përkatës një vërtetim me shkrim ku shënohen faktet relevante dhe shuma e mjeteve monetare të konfiskuara dhe të ndalura.

2.6 Instrumentet monetare të konfiskuara dhe të ndalura në pajtim me këtë nen do të mbahen në një llogari të veçantë, kur kjo është e mundur, pa interes për bartësin në emër të UNMIK-ut me BPK-në ose përndryshe mund të mbahen në një vend të sigurt në BPK deri në kohën kur të jetë paguar plotësisht gjoba ose ndryshe sipas urdhërit të gjykatës kompetente a kushteve të tjera që janë paraparë në këtë Urdhëresë administrative.

2.7 Nëse personi, valuta e të cilit është konfiskuar në pajtim me nenin 2.3, e paguan gjobën brenda 30 ditësh pas konfiskimit të tillë që fillimisht është dashur të paguhet, organi kompetent do të ndëmarrë masa për kthimin e mjeteve monetare përkatëse ose sipas rastit vlerën ekvivalente të tyre. Masat e tilla duhet të ndërmerren brenda 5 ditësh pas datës së pranimi të pagesës së gjobës.

2.8 Nëse personi, që paguan gjobën brenda 30 ditëve, siç është saktësuar në nenin 2.2 nuk është në gjendje që personalisht t'i marrë mjetet e konfiskuara monetare, ai ose ajo mund:

(a) T'ia dorëzojë autorizimin një personi tjetër me të cilin autorizohet personi i tillë që t'i marrë mjetet monetare të konfiskuara në emër të tij a të saj dhe t'i jep organit kompetent një dokument me shkrim të nënshkruar ose të noterizuar me të cilin udhëzohet organi kompetent që t'ia kthejë mjetet monetare një personi tjetër të emëruar dhe

(b) Të dorëzojë një kërkesë me shkrim, të drejtuar BPK-së për të depozituar mjetet monetare në një llogari të veçantë të UNMIK-ut në emër të personit të tillë deri në kohën kur mjetet monetare të merren personalisht nga personi përkatës ose nga personi i autorizuar për ta bërë ate në pajtim me nenin 2.8 (a).

2.9 Nëse gjoba paguhet plotësisht brenda periudhës kohore prej 30 ditësh të saktësuar në nenin 2.2, por instrumentet e konfiskuara monetare nuk merren brenda afatit prej 12 muajsh pas datës së konfiskimit, mjetet e tilla monetare do t'i dorëzohen UNMIK-ut dhe do të depozitohen në Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës.

2.10 Nëse personi nuk e paguan gjobën e shqiptuar sipas nenit 2.1 brenda afatit prej 30 ditësh, çështja do t'i referohet gjykatës kompetente për të vendosur në pajtim me nenin 3.

2.11 Personi kundër të cilit, në pajtim me nenin 2.1, i është shqiptuar dënimi me gjobë ose mjetet monetare të të cilit janë konfiskuar në pajtim me nenin 2.3, ka të drejtë ta kundërshtojë dënimin e shqiptuar me gjobë ose konfiskimin e tyre në një gjykatë kompetente brenda 30 ditësh pas datës së njoftimit për dënimin e shqiptuar ose pas pranimi të vërtetimit me shkrim që konfirmon konfiskimin.

### Neni 3 Procedurat gjyqësore

3.1 Gjykata kompetente, që ka të bëjë me lëndën, në pajtim me nenin 2.10 ose 2.11, mund:

(a) Të konfirmojë gjobën ose konfiskimin dhe sipas rastit të urdhërojë zbritjen e gjobës ap shpenzimeve të aplikueshme nga mjetet e konfiskuara monetare. Së këndejmi, bilanci do t'i dorëzohet UNMIK-ut dhe do të depozitohet në Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës dhe

(b) T'i lë me një vend ose ta zvogëlojë shumën e gjobës, t'i lë me një vend mjetet e konfiskuara apo të zvogëlojë shumën e mjeteve monetare që i nënshtrohen konfiskimit, nëse gjykata vendos se gjoba e vlerësuar ose konfiskimi nuk është bërë konform kësaj Urdhëresë administrative ose është në kundërshtim me ligjin në fuqi. Mjetet monetare me vlerë të këtyllë do të mbahen për një periudhë prej gjashtë (6) muajve, pas datës së urdhëresës së gjykatës, nëse personi përkatës nuk paraqitejt në gjykatë ose nuk i merr ato. Pas kalimit të afatit prej gjashtë (6) muaj ditësh, nëse mjetet monetare përkatëse nuk kërkohen nga personi përkatës

dhe nuk është lëshuar kurrfarë vendimi a urdhri nga gjykata kompetente, mjetet monetare të kësaj vlere do t'i dorëzohen UNMIK-ut dhe do të depozitohen në Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës.

3.2 Gjoha, konfiskimi dhe mbajtja e kryer në pajtim me nenin 2 dhe e kundërshtuar në procedurën gjyqësore do të vazhdojë pa kufizim, pavarësisht se a është kundërshtuar gjoha, konfiskimi dhe mbajtja e tillë në gjykatën kompetente, përveç rasteve kur është urdhëruar ndryshe nga gjykata e tillë ose është përcaktuar ndryshe në pajtim me këtë Urdhëresë administrative.

3.3 Nëpunësi i autorizuar nuk është personalisht përgjegjës dhe nuk mban përgjegjësi për dëmet ose humbjen e shkaktuar nga veprimet qëllimmira ose lëshimeve të bëra gjatë kryerjes së punëve zyrtare sipas kësaj Urdhërese administrative.

#### Neni 4 Masat administrative

Kjo Urdhëresë administrative do të zbatohet nën autoritetin dhe mbikëqyrjen e gjithmbarshme të UNMIK-ut nga zyrtarët e Autoritetit Qendror Fiskal, zyrtarët e doganave, policia, forcat e sigurimit dhe çdo autoritet tjetër i caktuar nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm.

#### Neni 5 Hyrja në fuqi

Kjo Urdhëresë administrative hyn në fuqi më 26 shkurt të vitit 2002.

Michael Steiner,  
Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm